



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

RREGULLORE
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORES
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Gjilan, dhjetor 2014

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 38 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më **30.12.2014**, miratoi këtë:

R r e g u l l o r e
Për ndryshim dhe plotësim të rregullores Për ndarjen e
Subvencioneve 01.nr. 16/16477 dt. 09.02.2012

Neni 1

1. Te neni 6 paragrafi 2 i rregullores bazë, shifra “2000” zëvendësohet me shifren “4000”.
2. Te neni 6 paragrafi 3 i rregullores bazë, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: “Nëse ndihmat financiare kanë të bëjnë me shumë më të madhe, se që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe në paragrafin 1 të nenit 9 të kësaj rregulloreje, vendosë Kuvendi i Komunës së Gjilanit”.
3. Te neni 6 paragrafi 4 dhe 5 fshihen.

Neni 2

Te neni 7 paragrafi 7 shtohet paragrafi 7.5 me këtë përmbajtje: “Raporti mbi përmylljen financiare të subvencioneve të pranuar në emër të realizimit të projektit”

Te neni 9 paragrafi 1 shifra “1200” zëvendësohet me shifren “1500”.

Neni 3

Pas miratimit të kësaj rregulloreje duhet të bëhet hartimi i tekstit të spastruar të rregullores për ndarjen e subvencioneve.

01.nr. 016-144327
Gjilan , më 30.12.2014

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku - Rexhepi

A r s y e t i m i

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 77 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr.16-531256 i datës 11.11.2011, në emër të Kryetarit të Komunës propozojë:

PROJEKT-RREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

- Meqenëse subvencionet përfshijnë transferet për subjektet e ndryshme, të ardhurat e të cilave nuk mbulojnë shpenzimet e tyre dhe për këtë diferencë kërkojnë të sigurojnë mbështetjen financiare nga komuna, andaj lidhur me shumatat e caktuara sipas Propozim Ndryshimit të Rregullores aktuale vendos Kryetari i Komunës dhe për shumata më të mëdha se për të cilat vendos Kryetari i Komunës, vendimin e merrë Kuvendi i Komunës si organ më i lartë në Komunë.
- Po ashtu me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje kërkohej që subjektet të cilat përfitojnë nga subvencionet, të paraqesin raportet e tyre lidhur me përmbylljen financiare të subvencioneve të pranuar për realizimin e projekteve.
- Me projektin e kësaj Rregulloreje bëhet eliminimi i dispozitave që bien ndesh me parimet themelore të përcaktuara me LVL-në përkatësisht nenin 40 pika c) dhe me ligjet tjera që rregullojnë financat publike dhe menaxhimin e tyre.
- Në kuptim të kësaj që u përmend në arsyetim të kësaj rregulloreje propozohet miratimi i saj nga anëtarët e KK-së.